



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 27, datë 27.11.2024

PËR

**RISHIKIMIN E KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI, SHËRBIMI DHE HOTELERIE 1-6 DHE 10-18 KATE MBI TOKË,
ME 4 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “DRITAN HOXHA”,
BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 17/1 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Nova Construction Group” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Rishikimin e kushteve të gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë banimi, shërbimi dhe hotelerie 1-6 dhe 10-18 kate mbi tokë, me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Dritan Hoxha”, Bashkia Tiranë, të miratuar me Vendimin Nr. 27, datë 27.07.2022, të Këshillit Kombëtar të Territorit, me subjekt zhvillues shoqërinë “Nova Construction Group” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 27, datë 27.07.2022, të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi, shërbimi dhe hotelerie 1-6 dhe 10-18 kate mbi tokë, me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Dritan Hoxha”, Bashkia Tiranë, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22 / 09 / 2025